“Atij që ma garanton atë që është mes dy nofullave dhe atë që është mes dy këmbëve, ia garantoj Xhenetin.”

Sehël ibën Sadi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Atij që ma garanton atë që është mes dy nofullave dhe atë që është mes dy këmbëve, ia garantoj Xhenetin.”
[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti na tregon në këtë hadith për gjëra, të cilave, nëse u përmbahet muslimani, ka për të hyrë në Xhenet: E para: ruajtja e gjuhës nga të folurit e gjërave që e hidhërojnë Allahun e Lartësuar. E dyta: ruajtja e organit intim nga rënia në kurvëri. I përmendi këta dy organe, sepse përmes tyre më së shumti bëhet mëkat.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3475